



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Data: 06.10.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 06.10.2022 të parashtruar nga OE Kosova Asfalt SH.P.K. nga Ferizaj lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Ndërtimi i rrugës Bujan me rrugën për Kraishtë”** me nr. të Prokurimit **613 022 099 521**

V E N D I M

I Aprovohet si pjeserisht e bazaur, kërkesa për ri-shqyrtim OE Kosova Asfalt SH.P.K. nga Ferizaj të dt.05.10.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Ndërtimi i rrugës Bujan me rrugën për Kraishtë me nr. të Prokurimit 613 022 099 521**

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të Ndryshoj disa nga kërkesat e parashtruara tek kërkesa për Kapacitet teknik dhe profesional duke u bazuar në kërkesën për rishqyrtim të OE Kosova Asfalt SH.P.K. nga Ferizaj
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të dërgohet OE ankues në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

OE N.P.SH BAGERI nga Ferizaj ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i rrugës Bujan me rrugën për Kraishtë" me nr. të Prokurimit 613 022 099 521

Pretendimi juaj i Parë.

c. Kamion Kiper me vinci me kapacitet min 10 m³, vinci me hapje 15-20 m. min 1 cope
Mendojme qe ky kriter eshte diskriminues dhe njekohesishte e favorizon nje kompani te caktuar dhe konkurenca eshte e kufizuar.

Duke pasur parasysh qe ne qdo oferte publike primare eshte transparenca dhe konkurenca e lire ju lusim ta largoni kete kriter ne menyre qe te na mundesohet te gjithëve pa dallime apo selektive aplikimi ne kete projekt.

Kjo kerkese e parashtruar ne NJK dhe DT eshte vendosur duke u bazuar ne projektin e lartcekur, ne kete projekt jane te parapra ne pozicionin (3) lshesa gypore dhe per vendosjen e tyre paraqitet nevoja per mjete pune siq eshte krani dhe qdo OE pjesmarres duhet te jete i paisur me kete mjet pune per realizimin e ketij projekti, dhe ju si OE duhet ti permbaheni kerkeses qe eshte e publikur ne NJK dhe DT.

Ky pretenim i juaji eshte i Pa Bazuar.

Pretendimi juaj i Dytë.

a). Min Nje inxhinier apo master i diplomuar i ndertimtarise drejtimi infrastruktur Rrugore te jete i certifikuar per sigurine e kantierit te ndertimit dhe mbrojtjen e shendetit, (minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit) i njeiti te caktohet edhe si menaxher i ketij projekti.

Gjithashtu kerkojme qe edhe per inxhinierin ne fjale te i largohen kerkesat per; te jete i certifikuar per sigurine e kantierit te ndertimit dhe mbrojtjen e shendetit.

Mendojme qe ky kriter eshte diskriminues dhe njekohesishte e favorizon nje kompani te caktuar dhe konkurenca eshte e kufizuar.

Kerkeses juaj konsiderohet si pjeserisht e bazuar dhe certifikata per sigurine e kantierit te ndertimit dhe mbrojtjen e shendetit largohet per kete inxhinier.

Ky pretenim i juaji eshte Pjeserisht i Bazuar.

Sqarim: Ndryshimet do te paraqiten tek kjo procedure dhe do te shtyhet afati i hapjes sipas ligjeve te LPP-se


AK ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thanë më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Bekim Shabani



Drejtor i Prokurimit